

Ligji Nr. 99/2024 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”

VKM Nr. 410, Datë 13.5.2015 “Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”

MISIONI DHE FUNKSIONET E ISHTI-SË

1. ISHTI-ja është struktura përgjegjëse për inspektimin për zbatimin dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e:

- a) përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, sipas legjislacionit përkatës;
- b) sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike, sipas legjislacionit përkatës;
- c) sigurisë së punës së instalimeve nën presion, si një linjë teknologjike e përbërë nga enë, tubacione dhe aksesore sigurie dhe që shërbejnë për mbajtjen, trajtimin dhe shpërndarjen e fluideve, sipas legjislacionit për sigurinë e enëve në presion;
- ç) sigurisë së punës në veprimtarinë e sektorit të gazit natyror, përfshirë transmetimin, shpërndarjen, depozitimin, si dhe ndërtimin e operimin e infrastrukturës së gazit natyror, sipas legjislacionit të sektorit të gazit natyror;
- d) sigurisë teknike të linjave teknologjike industriale të industrisë joushqimore, brenda fushës së përgjegjësisë së ministrisë përgjegjëse për industrinë, sipas legjislacionit përkatës;
- dh) çdo përgjegjësi tjetër të përcaktuar me ligj apo akt nënligjor.

ISHTI-ja si institucion ka këto funksione:

- a) Planifikon, bashkërendon dhe realizon veprimtarinë e inspektimit;
- b) Siguron unifikimin e praktikave të inspektimit, brenda fushës së përgjegjësisë, në shkallë vendi;
- c) Bashkërendon veprimtarinë e laboratorëve të saj dhe, në rastin e pamundësisë teknike së kryerjes së tyre nga laboratorët e saj, siguron kryerjen e analizave nga laboratorë të tjerë të akredituar;

- ç) Informon publikun për veprimtarinë e inspektimit;
- d) Jep mbështetje teknike, administrative dhe shkencore për veprimtarinë e inspektimit;
- dh) Përgatit programin e raportin vjetor të inspektimit dhe raportin mbi rastet e veçanta të inspektimit të kryera jashtë programit;
- e) “Kryen, sipas programit vjetor të miratuar paraprakisht prej ministrisë, inspektime të drejtpërdrejta në gjithë territorin e vendit në një apo disa fusha të caktuara inspektimi, si dhe inspektime të drejtpërdrejta të paplanifikuara për raste të veçanta, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, ndaj subjekteve që kryejnë veprimtari me rrezik të lartë”;
- ë) Kryen funksionet e shërbimeve të brendshme mbështetëse, të menaxhimit financiar dhe të auditimit të brendshëm;
- f) Kryen çdo funksion tjetër, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi.